



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Faza e dytë e prioriteteve politike BE - Kosovë:
Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) II

Tetor 2021
Prishtinë

Përmbajtja

<i>Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e PV ERA II</i>	<i>3</i>
<i>Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e PV ERA II</i>	<i>4</i>
Lista e shkurtesave dhe akronimeve	5
Hyrje	6
Lista e prioriteteve	7
<i>Shtylla I: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit.....</i>	<i>7</i>
<i>Shtylla II: Konkurrueshmëria, klima e investimeve dhe zhvillimi i qëndrueshëm</i>	<i>7</i>
<i>Shtylla III: Punësimi, arsimi dhe shëndetësia</i>	<i>7</i>
Plani i Veprimit për zbatimin e prioriteteve	8



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERISJA E KOSOVES - Vlada Kosova - GOVERNMENT OF KOSOVA	
Zyra e Kryeministrit - Zbirat Prishtine - OFFICE OF THE PRIME MINISTER	
SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Niveli Origjinaliteti / Originaliteti / Originality	02.1.9
Numri i Dokumentit / Document Number / No. of Document	1992/4
Numri i Kopjeve / Copies / No. of Copies	- 2 -
Data / Date / Datum	06 / 10 / 20 21
Prishtine / Pristina / Pristina	

Legjislatura VIII
Sesioni vjeshtor

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 67 të Rregullores së Kuvendit, në Seancën plenare të mbajtur më 4 tetor 2021, pasi e shqyrtoi Planin e Veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioritetëve politike të dakorduara ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës-Agjendës për Reforma Evropiane, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Plani i Veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioritetëve politike të dakorduara ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës-Agjendës për Reforma Evropiane II, me ndryshimin e propozuar nga Komisioni për Integrim Evropian.

Nr. 08-V- 078

Prishtinë, 04.10.2021

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit

Vendimi u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Komisioneve parlamentare dhe
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/24
Datë: 11.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Plani i Veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioritetëve politike të dakorduara ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës – Agjendës për Reforma Evropiane (PV ERA II).
2. Obligohen të gjitha institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës sipas Planit të Veprimit ERA II që ta zbatojnë atë, sipas afateve të parapara.
3. Buxheti për zbatimin e Planit të Veprimit ERA II, për veprimet e parapara për vitin 2021, mbetet brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për këtë vit dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij obligohen që të sigurojnë resurset e nevojshme buxhetore për zbatimin e veprimeve të parapara për vitin 2022 dhe 2023.
4. Obligohen të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit ERA II që të ndër marrin të gjitha masat e nevojshme që ai të ndërlidhet me planet e tyre të brendshme të punës dhe me dokumentet e tjera relevante.
5. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që ta dorëzoj Planin e Veprimit ERA II për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Lista e shkurtesave dhe akronimeve

AAP	Arsimimi dhe aftësimi profesional
AD	Akademia e Drejtësisë
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
AKEE	Agjencia Kosovare për Efiçencë të Energjisë
AKK	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
AKKK	Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit
AKKVP	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
ECDC	Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve
ERA	Agjenda për Reforma Evropiane
Eurojust	Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Çështje Penale
Europol	Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit
Frontex	Agjencia Evropiane e Rojeve Kufitare Tokësore dhe Detare
GjK	Gjykata Kushtetuese
IP	Inspektorati i Punës
KE	Komisioni Evropian
KGjK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
KKRF	Këshilli Kosovar për Raportim Financiar
KNSh	Këshilli për Ndihmë Shtetërore
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPM	Komisioni i Pavarur i Mediave
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MAShTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZrR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
ME	Ministria e Ekonomisë
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MKK	Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
MSh	Ministria e Shëndetësisë
NMVM	Ndërmarrje mikro, e vogël dhe e mesme
PRE	Programi për Reforma në Ekonomi
PSO	Procedurë standarde operative
PUK	Policia e udhëhequr nga inteligjenca
PV ERA	Plani i Veprimit për zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit
SISh	Sistemi Informativ Shëndetësor
UA	Udhëzim administrativ
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZRrE	Zyra e Rregullatorit për Energji

Hyrje

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet BE-së dhe Kosovës ka hyrë në fuqi në 1 prill 2016. Kjo marrëveshje është marrëdhënia e parë zyrtare kontraktuale që lidh BE-në dhe Kosovën së bashku. Ajo ofron mundësi dhe stimuj për Kosovën për të forcuar qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, si dhe për t'i dhënë hov rritjes ekonomike dhe punësimit. Ajo siguron zhvillimin gradual të një zone të tregtisë së lirë me BE-në, ndihmon në tërheqjen e investimeve të huaja dhe të brendshme, dhe në përmirësimin e mjedisit afarist.

Në mënyrë që **t'u jepet prioritet reformave të pritura si pjesë e zbatimit të MSA-së**, Kosova dhe BE kanë vendosur në vitin 2016 procesin e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA). Që nga viti 2016 ERA është bërë mjeti kryesor udhëzues për institucionet e Kosovës për reformat e lidhura me BE-në.

Faza e parë e ERA (ERA I) ishte rënë dakord në nëntor 2016. Që nga atëherë Kosova ka bërë përparime gjatë periudhës kohore në vijim në arritjen e rezultateve nga zotimet e marra përsipër. Ajo ka vendosur fokusin në tri shtylla, të cilat janë: i) Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, ii) Konkurrueshmëria dhe klima e investimeve, dhe iii) Arsimi dhe punësimi.

Kosova dhe BE tani kanë rënë dakord të fillojnë **fazën e dytë të ERA (ERA II)**, e cila bazohet në reformat dhe përparimet e arritura deri më tani. Kjo agjendë e re reformash prioritare ruan qasjen në tri shtylla, e cila është treguar shumë relevante, ndërsa gjithashtu pasqyron kontekstin dhe prioritetet në evoluim e sipër. Në veçanti, në kontekstin e pandemisë **COVID-19**, ERA II përfshin prioritete që lidhen me zbutjen e ndikimit ekonomik dhe social të krizës, si dhe një fokus të ri në sektorin e shëndetësisë. Po kështu, ERA II vë fokus shtesë në fushat e reformave që ndërlidhen me **Planin Ekonomik dhe të Investimeve** të Komisionit Evropian, të miratuar më 6 tetor 2020, siç është **tranzicioni i gjelbër**. Në shtyllën e **sundimit të ligjit** ka një fokus të ri në procesin e reformës zgjedhore, të drejtat themelore të njeriut dhe punët e brendshme.

Krejt në fund, prioritetet e ERA II janë plotësisht në përputhje me rekomandimet e përfshira në **Raportin** e Komisionit Evropian **për Kosovën – 2020** dhe me **Konkluzionet e Përbashkëta të vitit 2020 të Dialogut Ekonomik dhe Financiar** ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor e Turqisë.

Theks kyç i kësaj faze të dytë të ERA-s do të jetë në **implementimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe reformave** të miratuara në fazën e parë të ERA-s, në mënyrë që të sigurohen ndryshime reale për qytetarët, bizneset dhe investitorët.

Bazuar në prioritetet e dakorduara me BE-në, Qeveria e Kosovës – në konsultim të ngushtë me BE-në dhe me kontributin e shoqërisë civile – ka përgatitur Planin dyvjeçar të Veprimit të ERA-s (PV ERA II), i cili synohet të zbatohet deri në mesin e vitit 2023. PV ERA II ka përcaktuar hollësisht dhe me afate të qarta veprime specifike, realiste, të matshme dhe të arritshme për t'i realizuar këto prioritete ambicioze.

Hapat e ardhshëm: pas miratimit të PV ERA II do të vazhdohet me zbatimin dhe monitorimin e tij. Ky proces do të udhëhiqet nga Qeveria, e cila do të bashkëpunojë ngushtë me Komisionin Evropian. Në këtë proces gjithashtu do të përfshihen drejtpërsëdrejti institucionet e pavarura që kanë detyra konkrete për zbatim, ndërsa Qeveria gjithashtu do të bashkëpunojë ngushtë me shoqërinë civile në këtë drejtim.

Kuvendi i Kosovës do të luajë rol të rëndësishëm në zbatimin dhe monitorimin e ERA II, në veçanti në zbatimin e reformave nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të tij, miratimin e ligjeve dhe mbikëqyrjen e punës së Qeverisë në procesin e tërësishëm të zbatimit.

Ngjashëm, angazhimi i **shoqërisë civile** ka qenë thelbësor për përgatitjen e PV ERA II dhe duhet të jetë i tillë në monitorimin e zbatimit të tij. Për këtë qëllim janë organizuar konsultime të përbashkëta dhe publike me shoqërinë civile para finalizimit të planit të veprimit. Gjatë tërë kohës së zbatimit të tij gjithashtu do të organizohen konsultime të rregullta dhe të strukturuar të monitorimit me shoqërinë civile.

Nevojitet **angazhim i vendosur nga udhëheqësit politikë të Kosovës për këto reforma**, të cilat do të sjellin mundësi reale për tërë shoqërinë. Përmbyshja e veprimeve prioritare do të ndihmojë në zbatimin e MSA-së dhe avancimin e Kosovës në rrugën e saj evropiane. Zbatimi i ERA II do të analizohet hollësisht çdo vit.

Lista e prioriteteve

<i>Shtylla I: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit</i>	<i>Shtylla II: Konkurrueshmëria, klima e investimeve dhe zhvillimi i qëndrueshëm</i>	<i>Shtylla III: Punësimi, arsimi dhe shëndetësia</i>
<p>1.1. Avancimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe zbatimi i reformave kryesore në fushën e gjyqësorit dhe atë të punëve të brendshme</p> <p>1.2. Forcimi i mëtejshëm i performancës në zbatimin e reformës së administratës publike, bazuar në kornizën e re ligjore në fuqi</p> <p>1.3. Përmirësimi i zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore</p> <p>1.4. Forcimi i mëtejshëm i proceseve zgjedhore</p>	<p>2.1. Përmirësimi i tregut të brendshëm dhe i kapaciteteve për të mbështetur investimet, sektorin privat dhe NMVM-të</p> <p>2.2. Angazhimi drejt përmbushjes së caqeve të eficiencës së energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme</p> <p>2.3. Trajtimi i sfidave prioritare mjedisore</p> <p>2.4. Fuqizimi i mëtejshëm i zbatimit të menaxhimit të financave publike dhe reformave të prokurimit publik</p> <p>2.5. Fuqizimi i mëtejshëm i institucioneve të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore</p> <p>2.6. Vazhdimi i përpjekjeve për të trajtuar ekonominë joformale</p>	<p>3.1. Zbatimi i masave me objektiva të qartë për rimëkëmbje sociale dhe ekonomike pas COVID-19</p> <p>3.2. Përmirësimi i punësimit dhe mirëqenies së përgjithshme</p> <p>3.3. Përmirësimi i shëndetit dhe sigurisë në punë</p> <p>3.4. Përmirësimi i sistemit arsimor të Kosovës</p> <p>3.5. Forcimi i funksioneve kryesore të sistemit shëndetësor</p>

Plani i Veprimit për zbatimin e prioriteteve

Nr.	Nën-prioritetet	Veprimet	Treguesit (Mjetet e interpretimit)	Afatet kohore	Institucionet përgjegjëse
I. Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit					
1.1. Avancimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe zbatimi i reformave kryesore në fushën e gjyqësorit dhe atë të punëve të brendshme					
1.1.a.	Avancimi i integritetit llogaridhënies dhe besueshmërisë në sistemin e drejtësisë, sigurisë dhe rendit publik	1.1.a.1. Finalizimi i Strategjisë Sektoriale dhe Planit të Veprimit të Sundimit të Ligjit, bazuar në Rishikimin Funkcional	1.1.a.1.1. Strategjia Sektoriale e Sundimit të Ligjit, e miratuar	K2 2021	MD
			1.1.a.1.2. Strukturat për koordinimin dhe monitorimin të Strategjisë Sektoriale të Sundimit të Ligjit, të funksionalizuara	K4 2021	MD
			1.1.a.1.3. Raporte gjashtëmujore për zbatimin e planit të veprimit, të miratuara dhe të publikuara	K1 2022	MD
			1.1.a.1.4. Raporte vjetore gjithëpërfshirëse për zbatimin e strategjisë, të miratuara dhe të publikuara	K3 2022	MD
1.1.b.	Avancimi i kornizës ligjore në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar	1.1.b.1. Kompletimi dhe zbatimi i kornizës ligjore në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar	1.1.b.1.1. Draft Kodi i Procedurës Penale, i miratuar	K3 2021	MD Kuvendi
			1.1.b.1.2. Projektligji për Financimin e Subjekteve Politike, i miratuar	K3 2022	ZKM Kuvendi
			1.1.b.1.3. Projektligji për deklarimin, origjinën dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve publik, i miratuar	K3 2021	MD Kuvendi
			1.1.b.1.4. Projektligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, i miratuar	K3 2021	MD Kuvendi
			1.1.b.1.5. Aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit, të miratuara	K2 2022	AKKK
			1.1.b.1.6. Koncept dokumenti për krijimin e fondit të konfiskimit, i miratuar	K4 2021	MD
			1.1.b.1.7. Legjislacioni ekzistues, për të siguruar mandat të përhershëm dhe strukturë të qëndrueshme ligjore dhe organizative të Njësisë Speciale Hetimore, i amendamentuar	K4 2022	MPB
1.1.c.	Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës ligjore në fushën e falimentimit përmes miratimit të legjislacionit të nevojshëm dhe intensifikimi i zbatimit të legjislacionit në fushën e procedurës së përmbarimit dhe asaj të ndërmjetësimit, si dhe të noterisë dhe asaj të falimentimit	1.1.c.1. Kompletimi i akteve nënligjore për profesionet e lira	1.1.c.1.1. UA për shpërblimin për punën dhe kompensimin e shpenzimeve lidhur me punët e kryera nga noterët, i miratuar	K4 2021	MD
			1.1.c.1.2. UA për tarifën e përmbarimit, i miratuar	K4 2021	MD
			1.1.c.1.3. UA për tarifën e ndërmjetësuesve, i miratuar	K4 2021	MD
			1.1.c.1.4. UA për vet referimin e rasteve në ndërmjetësim, i miratuar	K4 2021	MD
		1.1.c.2. Përmirësimi i shërbimeve të profesioneve të lira duke kontribuar në rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë	1.1.c.2.1. Referimi i 10% të rasteve tek prokuroritë përmes ndërmjetësimit	K4 2022	KPK
			1.1.c.2.2. Referimi i 10% të rasteve gjyqësore tek gjykatat përmes ndërmjetësimit	K4 2022	KGjK
			1.1.c.2.3. Rekrutimi i shtatë (7) zyrtarëve të ndërmjetësimit në Prokuroritë Themelore	K4 2022	KPK
			1.1.d.	Intensifikimi i punës në rastet e nivelit të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke krijuar performancë të	1.1.d.1. Avancimi i mëtejshëm i kapaciteteve profesionale të PSRK-së dhe departamenteve speciale (në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe
1.1.d.1.2. Plani Strategjik kundër krimit të organizuar dhe rasteve të korrupsionit, i miratuar	K4 2022	MPB			

fuqishme të gjithëmbarshme në hetimin proaktiv, ndjekjes penale, dënimeve përfundimtare dhe konfiskimeve përfundimtare të pasurive të fituara me vepër penale, me vëmendje të veçantë në raste të transferuara nga EULEX-i	Gjykatën e Apelit) për të kryer hetime financiare, ndjekje penale, dënime të formës së prerë dhe konfiskim përfundimtar të pasurive të fituara përmes veprave penale	1.1.d.1.3. UA për Ekipe të Përbashkëta të Hetimit, i miratuar	K3 2021	MPB	
		1.1.d.1.4. Tre (3) prokurorë në Prokurorinë Speciale, të emëruar	K4 2022	KPK	
		1.1.d.1.5. Produktiviteti i gjyqtarëve dhe gjykatave duke llogaritur ngarkesën me lënde dhe efikasitetin në zgjidhjen e lëndëve (shkalla e spastrimit) përmes SMIL	K4 2021	KGJK	
		1.1.d.1.6. Hetimet financiare në të gjitha fazat e hetimeve penale për të gjitha rastet e lidhura me krimin e organizuar dhe korrupsionin, të kryera në mënyrë sistematike nga Policia e Kosovës	K4 2021- K4 2022	MPB	
		1.1.d.1.7. Përqindja (%) e rasteve të mbyllura me aktgjykime të formës së prerë në lidhje me rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë	K4 2021- K4 2022	KPK KGJK	
		1.1.d.1.8. Vlera e pasurisë së konfiskuar me aktgjykime të formës së prerë	K4 2021- K4 2022	KPK KGJK	
	1.1.d.2. Zbatimi i procedurave të konfiskimit në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit	1.1.d.2.1. Numri i procedurave të konfiskimit dhe numri i përgjithshëm i pasurive të konfiskuara	K4 2021- K4 2022	KPK KGJK	
	1.1.d.3. Hartimi dhe zbatimi i politikave trajnuese të specializuara për të forcuar kapaciteteve të institucioneve të sundimit të ligjit për të kryer hetime financiare, ndjekjen penale, dënimet përfundimtare dhe konfiskimet përfundimtare	1.1.d.3.1. Politikat e trajnimit për prokurorët dhe anëtarët e stafit mbështetës të sistemit prokurorial, të hartuara/miratuara	K4 2021	KPK	
		1.1.d.3.2. Pesëmbëdhjetë (15) prokurorë, 10 gjyqtarë dhe 10 hetues të policisë financiare për hetimet dhe gjykimin e krimit financiar, të trajnuar	K4 2021	AD	
		1.1.d.3.3. Një (1) trajnim për sekuestrim, për 20 prokurorë dhe 30 gjyqtarë, i organizuar	K4 2021	AD	
		1.1.d.3.4. Një (1) trajnim për 10 prokurorë dhe 15 gjyqtarë, për hetimin dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit, i organizuar	K4 2021	AD	
		1.1.d.3.5. Një (1) trajnim për 15 gjyqtarë dhe 10 prokurorë, për hetimin dhe gjykimin, i organizuar	K4 2021	AD	
		1.1.d.3.6. Pesë (5) trajnime për 40 zyrtarë policie mbi krimin ekonomik, të organizuara	K4 2021	MPB	
		1.1.d.3.7. Gjashtë (6) trajnime për 25 zyrtarë policie mbi krimin financiar, të organizuara	K4 2021	MPB	
		1.1.d.3.8. Pesëmbëdhjetë (15) trajnime për 130 zyrtarë policie mbi krimin e organizuar, të organizuara	K4 2021	MPB	
		1.1.d.3.9. Katër (4) trajnime për 40 zyrtarë policie për krimin ekonomik, të organizuara	K4 2022	MPB	
		1.1.d.3.10. Shtatë (7) trajnime për 20 zyrtarë policor mbi krimin financiar, të organizuara	K4 2022	MPB	
		1.1.d.3.11. Pesëmbëdhjetë (15) trajnime për 120 zyrtarë policor për hetimin e krimit të organizuar, të organizuara	K4 2022	MPB	
	1.1.e. Sigurimi i së drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme për të adresuar vonesat në procedurat gjyqësore	1.1.e.1. Rritja e efikasitetit dhe kapaciteteve të sistemit gjyqësor për të vendosur për raste komplekse pa vonesa të paarsyeshme në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit	1.1.e.1.1. Projektligji për mosmarrëveshjet administrative, i miratuar	K2 2022	MD
			1.1.e.1.2. Funksionalizimi i plotë i sistemeve të TIK-ut në gjykata, përfshirë këtu SMIL	K2 2022	KGJK
1.1.e.1.3. Koncept Dokumenti për realizimin e të drejtave civile përfshirë të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme			K2 2022	MD	
1.1.e.1.4. Respektimi i protokolleve kundër COVID-19 në sallat e gjyqimit dhe lokacionet e tjera nëpër gjykata, i siguruar			K4 2021	KGJK	

			1.1.e.1.5. Ndikimi i pandemisë COVID-19 dhe efektet e saj në praktikën aktuale dhe të ardhshme, në veçanti lidhur me grupet e cenushme dhe qasjen e tyre në drejtësi, të vlerësuar dhe adresuar	K4 2021	KGJK KPK MD	
			1.1.e.1.6. Infrastruktura e TI-së në të gjitha gjykatat, e vendosur dhe funksionale	K4 2021	KGJK	
1.1.f	Intensifikimi i luftimit të krimit të organizuar, përmes rritjes së bashkëpunimit dypalësh me Shtetet Anëtare të BE-së (përfshirë përdorimin e Ekipeve të Përbashkëta Hetimore), dhe luftimit të shpëlarjes së parave, luftimit të trafikimit të qenieve njerëzore e të armëve të zjarrit	1.1.f.1. Rritja e bashkëpunimit me agjencitë e BE-së (Europol, Eurojust dhe të tjera) dhe shtetet anëtare të BE-së	1.1.f.1.1. Marrëveshja për zyrtarin e ndërlidhjes me EUROPOL-in, e nënshkruar	K4 2021	MPB MPJD	
			1.1.f.1.2. Memorandumi i Mirëkuptimi për vendosjen e një linje të sigurt komunikimi me EUROPOL-in, i nënshkruar	K4 2021	MPB MPJD	
			1.1.f.1.3. Zyrtari ndërlidhës nga Policia e Kosovës në EUROPOL, i emëruar	K4 2021	MPB	
			1.1.f.1.4. Pajisjet e lidhjes SIENA në mjediset dhe sistemin e Policisë së Kosovës, të instaluar	K4 2021	MPB	
			1.1.f.1.5. Plani i Përbashkët në mes të Policisë së Kosovës dhe Guardia di Finanza, i hartuar	K4 2021	MPB	
			1.1.f.1.6. Numri i informacionit të shkëmbyer me shtetet anëtare për rastet e krimit të organizuar, përfshirë lëndët narkotike, trafikimin e qenieve njerëzore, pastrimin e parave dhe armët e zjarrit	K4 2021	MPB	
			1.1.f.1.7. Numri i informacionit dhe produkteve analitike të shkëmbyera me Frontex	K4 2021- K4 2022	MPB	
			1.1.f.1.8. Numri i oficerëve të policisë që marrin pjesë në aktivitete operacionale dhe ndërtimin e kapaciteteve të organizuara nga Frontex	K4 2021- K4 2022	MPB	
			1.1.f.1.9. Numri i oficerëve të policisë që marrin pjesë në trajnimet e organizuara nga CEPOL	K4 2021- K4 2022	MPB	
			1.1.f.1.10. Numri i operacioneve të përbashkëta të kryera dhe informacioni i shkëmbyer me vendet anëtare të BE-së	K4 2021- K4 2022	MPB	
		1.1.f.2. Avancimi i mëtejshëm i konceptit të policisë së udhëhequr nga inteligjenca në luftimin e krimit të organizuar	1.1.f.2.1. Hartimi i raportit të Vlerësimit të Kërcënimit nga Krimet e Rënda dhe Krimit të Organizuar (SOCTA), dhe transpozimi i tij në zbatim të procedurave të policimit të udhëhequr nga inteligjenca	K4 2021	MPB	
			1.1.f.2.2. UA dhe PSO për trajtimin e informatorëve, të hartuara dhe miratuara	K3 2021	MPB	
			1.1.f.2.3. Grupet punuese të koordinimit për ILP në nivelin qendror dhe lokal, të funksionalizuara	K3 2021	MPB	
			1.1.f.2.4. Gjashtëmbëdhjetë (16) zyrtarë të Policisë së Kosovës në 8 drejtori regionale, të emëruar dhe trajnuar	K3 2021	MPB	
			1.1.f.2.5. Gjashtëmbëdhjetë (16) kompjuterë të specializuar të lidhur me databazën e Inteligjencës për dërgimin e raporteve të informacionit të inteligjencës për çdo Stacion Policor, të instaluar	K3 2021	MPB	
			1.1.f.2.6. Ristrukturimi i Drejtorisë së Inteligjencës dhe Analizës (DIA) të PK-së në nivelin qendror për të përfshirë tryezat e inteligjencës strategjike dhe rritjen e nivelit të raporteve / informatave të inteligjencës të dorëzuar nga zyrtarët policorë	K4 2021	MPB	
		1.1.f.3. Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstytucional në luftën kundër krimit të organizuar.	1.1.f.3.1. Marrëveshja për shkëmbimin efikas të informacioneve ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit, e nënshkruar dhe zbatuar	K4 2021	MPB	
			1.1.f.3.2. Sistemi ARIS dhe Sistemi Qendror për Regjistrim Civil, të funksionalizuar dhe ndërlidhur	K2 2023	MPB MMPHI	
1.1.g		Të përmirësohet më tej korniza në fushën e migracionit dhe		1.1.g.1.1. Strategjia për Migrim 2020-2025, e miratuar	K3 2021	MPB
				1.1.g.1.2. Koncepti dokumenti për të Huajt, i miratuar	K4 2021	MPB

	atë të azilit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ato evropiane	1.1.g.1. Përmirësimi i politikave të migracionit dhe politikave të azilit, përfshirë ri integrimin dhe kthimin	1.1.g.1.3. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional në fushën e migracionit përmes AQM-së, i forcuar	K3 2021	MPB
			1.1.g.1.4. Mekanizmi funksional i referimit për të kthyerit me informacione mbi mbështetjen e ri integrimin në dispozicion, i themeluar	K4 2021	MPB
			1.1.g.1.5. Kapacitetet për përcaktimin e statusit të refugjatëve, të zgjeruara	K4 2021- K4 2022	MPB
			1.1.g.1.6. Masat e integrimin për refugjatët, të zbatuara	K4 2022	MPB
			1.1.g.1.7. Masat efektive dhe konkrete të mbrojtjes për individët jashtëzakonisht të ndjeshëm midis azilkërkuesve, të ndërmarra	K4 2022	MPB MFPT
			1.1.g.1.8. Mekanizmi sistematik për mbrojtjen e azilkërkuesve dhe fëmijëve refugjatë, i krijuar dhe funksionalizuar	K4 2021	MPB MFPT
			1.1.g.1.9. Regjistrimi biometrik i azilkërkuesve, funksional	K4 2022	MPB
			1.1.g.2.1 Qendra e Pritjes së Përkohshme, e funksionalizuar	K4 2021	MPB
			1.1.g.2.2. Procedurat e identifikimit, regjistrimit dhe referimit të duhur për emigrantët në ardhje brenda policisë kufitare, të zhvilluara dhe zbatuara	K4 2021	MPB
				1.1.g.2. Ngritja e kapaciteteve të pritjes dhe menaxhimit të flukseve me migrantë	1.1.g.2.3. Planet e kontingjencës – me përcaktimin e qartë të roleve, mandateve, përgjegjësi dhe shkaktarëve të fluksit – të azhurnuara
1.1.g.2.4. Plani i veprimit i QKMK, i zbatuar plotësisht	K4 2021				MPB
1.1.h.1.1. Strategjia për parandalimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, e miratuar	K4 2021				MPB
1.1.h.1.2. Përqindja (%) e zbatimit të Planit të Përbashkët të Veprimit BE-Ballkan Perëndimor kundër Terrorizmit deri më 31 dhjetor 2021/ dhjetor 2022	K4 2021- K4 2022				MPB
1.1.h.	Vazhdimi i përpjekjeve në luftën kundër terrorizmit, si dhe në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm	1.1.h.1. Avancimi i kornizës së politikave në luftën kundër terrorizmit, dhe zbatimi i Planit të Përbashkët të Veprimit BE -Ballkan Perëndimor Kundër Terrorizmit			
1.2. Forcimi i mëtejshëm i performancës në zbatimin e reformës së administratës publike, duke u bazuar në legjislacionin e ri kornizë në fuqi					
1.2.a.	Krijimi i një administrate publike efikase, efektive dhe llogaridhënëse në shërbim qytetar	1.2.a.1 Kompletimi dhe harmonizimi i kornizës së politikave për reformën e administratës publike	1.2.a.1.1. Projektligji për Pagat në Sektorin Publik, i miratuar	K2 2022	MPB Kuvendi
			1.2.a.1.2. Projektligji për Zyrtarët Publikë, i miratuar	K2 2022	MPB Kuvendi
			1.2.a.1.3. Gjashtë (6) rregullore për zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë, të plotësuara-ndryshuara	K4 2021	MPB
			1.2.a.1.4 Udhëzuesi për zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë, zhvilluar dhe miratuar	K4 2022	MPB
			1.2.a.1.5. Udhëzuesi për vlerësimin e performancës së agjencive ekzekutive për zbatimin e Ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, i zhvilluar dhe miratuar	K3 2021	MPB
			1.2.a.1.6. Strategjia e re për Reformën e Administratës Publike 2021-2026, e miratuar	K4 2021	MPB
1.2.b.	Përmirësimi i mëtejshëm i procesit të emërimit dhe shkarkimit të zyrtarëve të lartë publik, siç kërkohet nga ligji, dhe në përputhje me parimet e përzgjedhjes transparente,	1.2.b.1. Rritja e cilësisë së menaxhimit të performancës dhe llogaridhënies.	1.2.b.1.1. Memorandum shpjegues për ligjin për inspektim administrativ, i hartuar	K4 2021	MPB
			1.2.b.1.2. Projektligji për inspektimin administrativ, i miratuar	K2 2022	MPB Kuvendi
			1.2.b.1.3. Modulet për të gjitha procedurat e rekrutimit, transferimit dhe avancimit në kuadër të SIMBNJ, të zhvilluara	K4 2021	MPB
			1.2.b.1.4. Udhëzuesi për zhvillimin e intervistës, i zhvilluar dhe miratuar	K3 2021	MPB

	meritore dhe jopolitike, si dhe ndërmarrja e hapave të parë për të vënë në zbatim menaxhimin e performancës dhe përmirësimi i llogaridhënies menaxheriale në shërbimin civil.	1.2.b.2. Të sigurohen emërimet në baza meritore dhe jopolitike për të gjitha nivelet, veçanërisht për Bordet e Drejtorëve, duke përfshirë zbatimin e Memorandumeve të Bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit të Kosovës, Qeverisë së Kosovës dhe Ambasadës Britanike në Kosovë	1.2.b.1.5. Trajnimi i Njësive për Burime Njerëzore të institucioneve lidhur me përcaktimin e objektivave për vlerësim, i organizuar	K2 2022	MPB
			1.2.b.1.6. Trajnimi i anëtarëve të Komisionit Shtetëror për Pranim të Nivelin e Lartë Drejtues (NLD) për procedurat e rekrutimit dhe zhvillimit të intervistës, i organizuar	K2 2022	MPB
			1.2.b.1.7. Banka e pyetjeve për NLD, e krijuar	K3 2021	MPB
			1.2.b.2.1. Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të Kuvendit, Qeverisë së Kosovës dhe Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, i zbatuar	K4 2021	Kuvendi ZKM
			1.2.b.2.2. Udhëzuesi për zhvillimin e intervistës, përgatitur në bashkëpunim me projektin britanik dhe projektin e BE-së, i miratuar	K4 2021	MPB
1.2.c.	Vazhdimi i procesit të racionalizimit të institucioneve dhe agjencive të pavarura	1.2.c.1. Zbatimi i procesit të racionalizimit	1.2.c.1.1. Projektligji për valën e parë të racionalizimit të agjencive, i miratuar	K1 2022	MPB Kuvendi
			1.2.c.1.2. Memorandum shpjegues rreth projektligjit për valën e dytë të racionalizimit të agjencive, i miratuar	K3 2021	MPB
			1.2.c.1.3. Projektligji për valën e dytë të racionalizimit të agjencive, i miratuar	K2 2022	MPB Kuvendi
			1.2.c.1.4. Koncept dokumenti për valën e tretë të racionalizimit të agjencive, i miratuar	K3 2022	MPB
			1.2.c.1.5. Projektligji për valën e tretë të racionalizimit të agjencive, i miratuar	K1 2023	MPB Kuvendi
			1.2.c.1.6. Koncept dokumenti për valën e katërt të racionalizimit të agjencive, i miratuar	K4 2022	MPB
			1.2.c.1.7. Projektligji për valën e katërt të racionalizimit të agjencive, i miratuar	K2 2023	MPB Kuvendi
1.2.d.	Përafrimi i legjislacionit me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe përqendrimi në zvogëlimin e barrës administrative, përfshirë masat që ndërlidhen me TI	1.2.d.1. Zvogëlimi i barrës administrative të lejeve dhe licencave	1.2.d.1.1. Të paktën 20% të projektligjeve ekzistuese, draft ligjeve, akteve nënligjore dhe udhëzimeve administrative që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe janë pjesë e programit legjislativ, të harmonizuara me LPPA	K4 2021	MPB
			1.2.d.1.2. Të paktën 8% të lejeve dhe licencave për operatorët ekonomik, të thjeshtuara, bashkuara apo të shfuqizuara	K4 2021	ZKM
			1.2.d.1.3. Regjistri qendror për leje dhe licenca, i avancuar dhe përditësuar	K4 2021	ZKM
1.3. Përmirësimi i zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore					
1.3.a.	Ndërmarrja e hapave konkretë për të forcuar rolin koordinues brenda Zyrës së Kryeministrit në zbatimin e legjislacionit për të drejtat e njeriut	1.3.a.1. Forcimi i kapaciteteve të ZQM brenda ZKM për të përmbushur mandatin e saj në zbatimin e legjislacionit për të drejtat e njeriut	1.3.a.1.1. Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, i miratuar	K3 2021	ZKM
			1.3.a.1.2. Strategjia për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre 2021-2025, e miratuar	K4 2021	MKK
			1.3.a.1.3. Sistemi elektronik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit (nivel lokal dhe qendror), i funksionalizuar	K3 2022	ZKM
			1.3.a.1.4. Hulumtimi mbi perceptimin qytetarëve për diversitetin dhe barazinë në vend, i përfunduar dhe raporti i hartuar	K2 2021	ZKM

			1.3.a.1.5. Ngritja së paku në 60% e implementimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe 95% sigurimi i përgjigjeve për rekomandimet e adresuara brenda afatit ligjor	K4 2021	ZKM
			1.3.a.1.6. Grupi koordinues ndërmintor për zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur, i themeluar	K2 2022	MKK
			1.3.a.1.7. Sistemi i menaxhimit të të dhënave në lidhje me personat e zhvendosur dhe të kthyerit, i themeluar dhe funksional	K2 2022	MKK
			1.3.a.1.8. Komisioni Qendror i Ankesave i bazuar në Rregulloren (QRK) - NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme, i themeluar	K2 2022	MKK
1.3.b.	Sigurimi i zbatimit të vendimeve gjyqësore, në veçanti për të drejtat pronësore, përfshirë ato të Gjykatës Kushtetuese	1.3.b.1. Përmirësimi i legjislacionit në fushën e të drejtave pronësore.	1.3.b.1.1. Projektligji për AKKVP-në, i miratuar	K1 2022	ZKM Kuvendi
			1.3.b.1.2. Rregulloret në kuadër të Ligjit për AKKVP, të hartuara dhe miratuara	K4 2022	AKKVP
		1.3.b.2. Zbatimi i kërkesave për ri-posedim të parashtruesve të suksesshëm të kërkesave	1.3.b.2.1. Dëbimi i uzurpuesve të paligjshëm, përkatësisht realizimi i 40% të kërkesave aktive	K4 2021	AKKVP
			1.3.b.2.2. Dyzet (40%) ndaj kërkesave për ri-posedim në pronat ku ekzistojnë uzurpuesit e paligjshëm, të realizuara	K4 2021	AKKVP
		1.3.b.3. Shkatërrimi i strukturave të paligjshme.	1.3.b.3.1. Katër (4) vendime sipas kërkesës për shkatërrim apo mjeteve tjera të parapara me kornizën ligjore të Agjencisë, të ekzekutuara	K4 2021	AKKVP
		1.3.b.4. Sigurimi i zbatimit të vendimeve gjyqësore, në veçanti për të drejtat pronësore, përfshirë ato të Gjykatës Kushtetuese	1.3.b.4.1. Vendime të pazbatuara të GjK, të dërguara në prokurori	K4 2021	GjK
1.3.c.	Avancimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore përmes zbatimit dhe zbatimit me detyrim, plotësisht, të legjislacionit që trajton ndërtimet e paligjshme. Miratimi i Ligjit për trashëgiminë kulturore dhe Ligjit për liritë fetare dhe sigurimi i funksionimit aktiv të Këshillit për Zbatim dhe Monitorim	1.3.c.1. Finalizimi dhe miratimi i legjislacionit për trashëgiminë kulturore dhe liritë fetare duke harmonizuar sistematikisht legjislacionin e trashëgimisë kulturore me atë të BE-së	1.3.c.1.1. Projektligji për trashëgiminë kulturore, i miratuar	K4 2022	MKRS Kuvendi
			1.3.c.1.2. Akte nën ligjore në kuadër të avancimit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, të hartuara dhe të miratuara	K4 2022	MKRS
			1.3.c.1.3. Projektligji për liritë fetare, i miratuar	K3 2022	ZKM Kuvendi
			1.3.c.1.4. Akte nën ligjore në kuadër të ligjit për liritë fetare, të hartuara dhe miratuara	K4 2022	ZKM
		1.3.c.2. Sigurimi i funksionimit aktiv të Këshillit të Zbatimit dhe Monitorimit	1.3.c.2.1. Këshilli i Zbatimit dhe Monitorimit, plotësisht funksional	K4 2022	MMPHI
			1.3.c.2.2. Zbatimi i plotë i legjislacionit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura	K4 2022	MMPHI
1.3.d.	Përmirësimi i efektivitetit të përgjithshëm të Agjencisë për Regjistrim Civil, përfshirë shërbimet e saj për komunitetet e cenueshme dhe pakicat	1.3.d.1. Rritja e efektivitetit të shërbimeve të ofruara nga ARC përmes digjitalizimit, automatizimit, ofrimit të shërbimeve online dhe ndërlikohjes së sistemeve	1.3.d.1.1. Sistemet elektronike të ARC-së të ndërlidhura me sistemet elektronike të paktën 5 institucioneve të tjera qeveritare përmes implementimit të platformës elektronike Government Gateway (GG)	K4 2022	MPB
			1.3.d.1.2. Faza e tretë e digjitalizimit të librave të skanuar, përkatësisht verifikimi i të dhënave dhe lidhja / përputhja e të dhënave, e zbatuar	K4 2022	MPB
		1.3.d.2. Funksionalizimi i zyrave të gjendjes civile në komunat veriore	1.3.d.2.1. Ofrimi i shërbimeve të gjendjes civile në komunat veriore	K4 2022	MPB

		1.3.d.3. Rishikimi dhe harmonizimi i kornizës ligjore	1.3.d.3.1. Rishikimi i kornizës ligjore dhe popullimi i regjistrit qendror me të gjitha të dhënat e qytetarëve, përfshirë ato historike, duke zvogëluar rastet e personave pa dokumente	K4 2022	MPB
			1.3.d.3.2. Projektligji për shtetësinë, i plotësuar-ndryshuar	K4 2022	MPB
			1.3.d.3.3. Projektligji për banesa dhe vendbanime, i plotësuar-ndryshuar	K4 2022	MPB
1.3.e	Përmirësimi i reagimit ndaj dhunës në familje, ngacmimit seksual dhe veprave të tjera me bazë gjinore. Përmirësoni mbrojtjen efektive të të drejtave të fëmijëve	1.3.e.1. Avancimi i kornizës së politikave në luftën kundër dhunës në familje, ngacmimit seksual dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore si vepra të paligjshme me bazë gjinore, përfshirë dhunën seksuale, ekonomike dhe psikologjike	1.3.e.1.1. Projektligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunën në baza gjinore, i miratuar	K2 2022	MD Kuvendi
			1.3.e.1.2. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër dhunës në familje, i miratuar	K1 2022	MD
			1.3.e.1.3. Katër (4) trajnime në PSO për mbrojtjen nga dhuna në familje, të mbajtura	K4 2021	ZKM
			1.3.e.1.4. Fushatë vetëdijësuese për parandalimin e dhunës në familje, e organizuar	K4 2021	ZKM
		1.3.e.2. Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e fëmijëve	1.3.e.2.1. Gjashtëmbëdhjetë (16) UA që rrjedhin nga ligji për mbrojtjen e fëmijëve, të miratuara	K2 2022	ZKM MFPT MPB MAPL MASHTI MSh KGJK KPK
		1.3.e.3. Mbështetja e fuqizimit ekonomik të grave	1.3.e.3.1. Mbështetje në sipërmarrje për gratë që vijnë nga komunitetet jo-shumicë, e ofruar	K4 2022	MKK
1.3.f.	Sigurimi i funksionimit të pavarur editorial dhe financiar të transmetuesit publik si dhe miratimi dhe zbatimi i politikave/ligjeve të lidhura me mediat, në përputhje me standardet e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias. Sigurimi i mbrojtjes së duhur të gazetarëve për të ushtruar profesionin e tyre lirshëm	1.3.f.1. Avancimi i kornizës ligjore e strategjike në fushën e mediave	1.3.f.1.1. Projektligji për Komisionin e Pavarur për Media, i rishikuar	K2 2021	ZKM Kuvendi
			1.3.f.1.2. Rregullorja për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet e mediave audio-vizuale (plotësim-ndryshim), e miratuar	K4 2021	KPM
			1.3.f.1.3. Rregullore për komunikimet audio-vizuale tregtare (plotësim-ndryshim), e miratuar	K4 2021	KPM
			f.1.4. Rregullore për pronësinë dhe përqendrimin e ofruesve të shërbimeve media dhe audio-vizuale, e miratuar	K4 2021	KPM
		1.3.f.2. Sigurimi i pavarësisë, profesionalizmit dhe qëndrueshmërisë financiare të transmetuesit publik	1.3.f.2.1. Projektligji për transmetuesin publik, i miratuar	K4 2022	Kuvendi
		1.3.f.3. Mbrojtja e gazetarëve dhe sigurimi i mjedisit të sigurt për të ushtruar profesionin e tyre	1.3.f.3.1. Koncept dokumenti për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve, i hartuar	K4 2021	ZKM
			1.3.f.3.2. Numri i rasteve të sulmeve kundër gazetarëve të hetuar në mënyrë efektive nga policia	K4 2021 – K4 2022	MPB
			1.3.f.3.3. Numri i informacionit i shkëmbyer reciprokisht me Shoqatën e Gazetarëve	K4 2021 – K4 2022	MPB
			1.3.f.3.4. Numri i takimeve të përbashkëta të organizuara me Shoqatën e Gazetarëve për shkëmbimin e informacionit	K4 2021 – K4 2022	MPB
1.4. Forcimi i mëtejshëm i proceseve zgjedhore					
1.4.a.			1.4.a.1.1. Komiteti ad-hoc dhe Grupi Këshillues, të themeluar	K3 2021	Kuvendi

	Zbatimi i rekomandimeve të misioneve të BE-së për vëzhgim të zgjedhjeve	1.4.a.1. Të adresohen rekomandimet që lidhen me ndryshim të legjislacionit, vendimeve qeveritare si dhe alokimit të burimeve financiare	1.4.a.1.2. Projektligji për zgjedhjet, i miratuar	K2 2023	Kuvendi
		1.4.a.2. Forcimi i drejtësisë zgjedhore, duke përfshirë trajtimin e ankesave zgjedhore si dhe parandalimin e shkeljeve zgjedhore	1.4.a.2.1. Manualet e trajnimit, të përditësuara	K3 2021	KQZ PZAP
			1.4.a.2.2. Trajnimet për parandalimin e mashtrimeve zgjedhore, të mbajtura	K3 2021	KQZ PZAP
		1.4.a.3. Adresimi i rekomandimeve në kuadër të regjistrimit të qytetarëve dhe votuesve	1.4.a.2.3. Aktivitete të organizuara për informim të votuesve rreth shkeljeve zgjedhore, të organizuara	K3 2021	KQZ PZAP
1.4.a.3.1. Rritja e saktësisë së listës së votuesve përmes përditësimit të listës së pensionistëve nga viti 2000 deri tani.	K3 2021		KQZ PZAP		
1.4.b.	Miratimi dhe zbatimi i legjislacionit të ri për financimin e subjekteve politike, në përputhje me opinionin e Komisionit të Venedikut	1.4.b.1. Kompletimi dhe zbatimi i kornizës ligjore në fushën e financimit të subjekteve politike	1.4.a.3.2. Sistemi ARIS dhe Sistemi Qendror për Regjistrim Civil, të funksionalizuar dhe ndërlidhur ¹	K2 2023	MPB MMPHI
			1.4.b.1.1. Projektligji për financimin e subjekteve politike, i miratuar	K3 2022	ZKM Kuvendi
			1.4.b.1.2. Auditimet e rregullta të partive politike, të kryera në kohë	K4 2021	Kuvendi
			1.4.b.1.3. Numri i raporteve financiare të subjekteve që pas auditimit marrin opinionin 'Mohim i Opinionit'	K4 2021	KQZ
II. Konkurrueshmëria, klima e investimeve dhe zhvillimi i qëndrueshëm					
2.1. Përmirësimi i tregut të brendshëm dhe i kapaciteteve për të mbështetur investimet, sektorin privat dhe NMVM-të					
Promovimi i investimeve të huaja direkte					
2.1.a.	Forcimi i dukshëm i kapaciteteve të Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) për të përmirësuar performancën e saj për promovimin dhe mbështetjen e investimeve, sektorit privat dhe zhvillimit të NVM-ve	2.1.a.1. Hartimi dhe miratimi i rregullores së re organizative të KIESA-së	2.1.a.1.1. Struktura organizative e KIESA-së e miratuar e cila adreson aspektet kryesore të përmirësimit të performancës: ndarjen e përgjegjësisë, burimeve financiare dhe kapaciteteve njerëzore	K2 2022	MINT
2.1.b.	Krijimi i një programi të kujdesit pasues për investitorët potencialë dhe atyre aktualë në Kosovë dhe një mekanizmi të ankesave të investitorëve, me kapacitete profesionale për të ofruar shërbime të tilla.	2.1.b.1. Themelimi i mekanizmave të kujdesit pasues	2.1.b.1.1. Mekanizmi i ankesës, i krijuar	K1 2022	MINT
			2.1.b.1.2. Programi i kujdesit, i miratuar	K4 2022	MINT
			2.1.b.1.3. Njësia e kujdesit për investitorët, e themeluar	K1 2022	MINT
			2.1.b.1.4. Auditimi i performancës i KIESA, i realizuar	K2 2022	MINT
			2.1.b.1.5. Vlerësimi i performancës së skemave mbështetëse për bizneset të KIESA-s, i realizuar	K4 2022	MINT
Përmirësimi i mjedisit afarist					
2.1.c.	Përmirësimi i menaxhimit, koordinimit dhe zbatimit me	2.1.c.1. Përafrimi i legjislacionit në fushën e sigurisë së përgjithshme të	2.1.c.1.1. Koncept dokumenti për sigurinë e përgjithshme të produkteve, i miratuar	K4 2021	MINT
